

Paraqitje e Triviumit

Triviumi është themeli i shtat arteve liberale. Ai bazohet në tri fakultetet e njeriut: arsyen, ndjenjat, dhe vullnetin. Secili fakultet është i skajuar në të dy anët: intelekti ka *përcepte (shqisime) dhe koncepte*, ndjenjat kanë *dhimbje dhe kënaqsi*, dhe vullneti mund të jetë *i dobët ose i fortë*. Por, Triviumi duhet përsëri një subjekt trefish, jo si tri subjekte të veçanta. Pa njohë gramatikën, është e vështirë me ndërtua propozime logjike. Pa njohë gramatikën e logjikën është e vështirë me e përdorë gjuhën efektivisht; sëpaku në mënyrë të qëllimëshme.

Fazat e Edukimit

Programi edukativ i triviumit përkton me tri fazet a zhvillimit të njeriut:

gramatikën:	<i>emënimin e botës</i>
logjikën:	<i>arsyetimin rreth botës</i>
retorikën:	<i>përdorimin e qëllimshëm të gjuhës</i>

Gramatika

Fillimisht fëmijët mësojnë me emnua qenjet e botës dhe ngjarjet që ata dëshmojnë. Kjo fazë nisë në moshën dy vjeç dhe vazhdon gjith jetën. Si kompetencë gjuhsore, nxanja e gramatikës përkton me studimin e standardit zyrtar dhe të normës letrare të vendit ku edukohet fëmija ose ku studjon nxanësi. Në Shqiptari kompetenca gjuhsore kërkon a) njohjen e standardit *me bazë geqe (Prishtinë, 1964)* ose të atij *me bazë toske (Tiranë, 1972)*, dhe b) leximin e teksteve në gjuhën shqipe me cak familjarizimin me praktikatat më të mira të *normës letrare*.

Nëpërmjet *simboleve gjuhsore* **gramatika** kumton perkapjet shqisore dhe përsihatjet e mendjes, përfshi edhe imagjinatën. Gjuha mund të shprehë çdo gjë që gjindet në mendjen e njeriut; por asgjë që nuk gjindet në të. Studimi i kësaj fushe i ndihmon nxanësit me ndërtua kumte korrekte.

Gramatika është faza e parë e Triviumit. Ajo febron ndamjen e fjalëve në klasa, eptimin (zgjedhimin dhe lakimin e fjalëve), formimin e fjalëve të reja, dhe mënyrat si fjalët lidhen me cak ndërtimin e një kumti a ideje të plotë. Si e tillë, gramatika anglon themelet e dijes me cak diskursin; përdorimin e gjuhës nergut me kumtua një bindje a me bindë dikë rreth një pikpamieje. Kjo fazë shërben me përvetsua faktet dhe informacionin bazë rreth cilësdo landë; për shembull, termat e randesishëme, faktet historike e shkencore, the rregullat që udhzojnë zbulimin dhe kumtimin e informacionit në fusha të ndryshëme të dijes. Këto aspekte të gjuhës u nevojiten të gjithëve, prej studentëve te shkrimtarët. Ato formojnë bazat e logjikës dhe retorikës. Për shembull, një fjalë që në gramatikë mund të quhet deklarative, në logjikë mund të quhet premisë, dhe në retorikë mund të shihet si një kumt me cak ndikimin mbë një audiencë specifike.

Logjika

Duke nisë qysh në shkollë të mesëme, dhe veçsisht në universitet, nxanësit jepen pas argumentesh personale, morale, shoqnore, e politke. Prandaj është e nevojëshme që ata të nxanë sa më shum rreth ndërtimit të argumenteve të vlerta a të shëndosha; dhe rreth falsiteteve logjike. Diskursi nuk mund ta fshijë natyrën njerzore; njeriu është një qenje emocionale e dhanun pas konceptesh që afirmojnë

nevojat e vetdijëshme dhe të pavetdijëshme të tij. Logjika i ndihmon njeriut të ngrihet mbi nxitjet emocionale.

Duke u mbështetë në *parimet e arsyes* **logjika** ndjekë arsyetimin, jo emocionet e vullnetin. Ajo kumton atë që mund të dihet ose atë që mund të egzistojë; bindjet e vlerta (en. valid) ose të shëndosha (en. cogent). Kjo u ndihmon veçsisht nxanësve me dallua bindjet personale e nxitjet emocionale prej arsyetimeve të logjikëshme.

Logjika, faza e dytë e triviumit, febron mënyrat si premiset e udhheqin menduesin drejt një përfundimi të vltetë ose kogjent. Ky aspekt themelor i filozofisë, matematikës, shkencave, dhe teknologjisë, tipikisht ndahet në logjikë deduktive (formale), e cila febron formën ose strukturën e argumentit the validitetin e përfundimit të argumentit, dhe në logjikë induktive (materiale), e cila febron të vërtetën e argumentit në botën reale. Ka edhe logjikë abduktive, a cila febron shjegimin mâ të mirë të mundëshëm.

Logjikë *jo-formale*, është një mënyrë tjetër arsyetimi, metodat dhe parimet e të cilës dobisohen me analizua dhe vlersua ndërtimin e argumenteve në situata praktike (jetës së vërtetë), ku përfshihen bisedat, debatet, dhe tekste e çfarëdoshëme. Disa aspekte të vlerta të kësaj metode përfshijnë hulumtimin e falsiteteve logjike dhe vlersimin e të së vërtetës së argumentit.

Retorika

Retorika është baza e stilit të ligjruesit e shkrimtarit sepse ajo ndihmon në qartsimin dhe efektivitetin e kumtit. Tipikisht, nxanësit e avancuom të shkollave të mesëme e nisin mësimin e retorikës kah vitet e fundit dhe e vazhdojnë atë në universitet.

Duke marrë parasysh situatën dhe audiencën, retorika cakon me ndikua mbë vullnetin e dëgjuesve a shikuesve. Prandaj, përdoruesi i retorikës përpiqet me identifikua dhe me analizua mënyrat si një kumt mund të *komunikohet sa mâ efektivisht*. Për këtë arsye, gramatika dhe logjika janë pre-rekuizita të retorikës; para se me nise studimin e retorikës, studenti duhet të ketë njohje sa mâ të thellë të gramatikës dhe familjarizim sa mâ të plotë me logjikën.

Retorika, dasina e tretë e triviumit, është arti i bindjes së të tjerëve. Ajo përkufizohet si përdorimi i mjeteve të mundëshme me bindë një audiencë specifike në një situatë të caktuome (Aristoteli).

Tipikisht, studentët mund ta studjojnë këtë aspekt në klasat a fundit të shkollës së mesëme ose në fillim të universitetit. Por, ky është vetëm fillimi; retorika, ashtu si gramatika e logjika, është një nxanje që zgjatë tan jetën.

Retorika ka nam të keq. Ajo të sjellë në mendje shitësit fjalshumë, reklamuesit fjalshpejtë, politikanët që nuk e mbajnë fjalën, dhe fjalimet mashtruese të avoketëve në sallat e gjyqit. Por, kjo është vetëm ana e errët e saj.

Retorika nuk mund të zhvillohet plotsisht pa ditë gramatikën sepse detyra e saj është me i njohë rregullat gramatikore me qëllim 'thymjen' e tyne. Retorika nuk mund të zhvillohet as pa logjikën sepse, para se me ndikua mbë një auditor të caktuom, retoriti i duhet me njohë mënyrat e arsyetimit dhe falsitetet logjike. Retoriti i kërkohet edhe me njohë natyrën e njeriut, diçka që nuk mund ta mësohet prej kujt as t'ia mësohet prej kujt. Për këtë arsye, retorika mund të quhet art, jo shkencë.

Nxanja e retorikës nevojitet sepse ajo ofron njohjen e mënyrave si gjuha mund të ndikojë mbë një audiencë të caktuome. Ajo e ban njeriun të vetdijëshëm rreth forcës së fshehtë të ndërkumtit njerzor (Georgias of Leontini).

Krahasimi i Arteve Liberale me Artet Tjera

Fjala ‘liberal’ vjen prej latinishtes; prej të cilës perëndimi trashëgon fjalët ‘lirí’ dhe ‘í lirë’. Kështu, artet liberale mund të kuptohen si aftsitë e njeriut të lirë, veçsisht të lirë prej emocioneve dhe fanaticizmit. Me fjalën τέχνη tékhne (art) Grekët e lashtë kuptonin bamjen ose prodhimin e diçkaje prej njeriut. Edhe ‘poesis’, në kuptimin që atë e përdorë Aristoteli, dhe e cila sot nënkupton shkrimin kreativ, do të thotë ‘me prodhua’ diçka. Si prodhime njerzore, tekne dhe poesis dallohen prej prodhimeve natyrore.

Prodhimtaria njerzore mund të ndahet në trí kategori:

1. Artet *liberale* (en. liberal arts), të cilat kanë vlera **rafinuese** për personin që i zotnon ato, sepse ato ndihmojnë në rafinimin e gjuhës, arsytimit, dhe ndërkumtit.
2. Artet e *bukura* (en. fine arts) kanë vlera **psikologjike** për klientët dhe prodhuesit e artit; si për atë që prodhon ose blen *Mona Liza*en, si për atë që e quan art *Urinalin* e Marcel Duchampit. Prejse arti lidhet me kënaqsinë psikologjike, ai mund të përdoret retorikisht ose mund të degradohet në art për hir të artit.
3. Artet e *dobishëme* (en. utilitarian arts) përfshijnë mjeshtritë praktike që nevojiten me jetua, p.sh., arti i punimit të tokës, arti i rafinimit të remit, arti i përpunimit të arencit, arti i ruajtjes së shëndetit, e të tjera.

Mjeshtria e një karpantjeri, doktori, a shitësi, sado të dhuntuom (G) të jenë ata, paguhet prej klientëve. Këto janë *artet e dobishëme*—artet që prodhojnë diçka me vlerë **praktike**, p.sh., ndërtimin e shtëpive, foshkimin prej ligsinave, shitjen e artikujve në një shitore, e të tjera. Edhe *artet e bukura* kanë vlera monetare sepse njerzit paguajn me përmbushë nevojat e tyre **psikologjike**, p.sh., adhuruesi i pikturave blen portretet, i dashunuomi pas muzikës jepet pas simfonive, dhe dikush tjetër ndjekë dramën. Kurse, vlerat e *artëve liberale* janë të paqarta. Për shembull, fakti që dikush zotnon *gramatikën*¹, *logjikën*², *e retorikën*³, ose ka njohuri rreth parimeve të *matematikës*⁴, *muzikës*⁵, *gjeometrisë*⁶, ose *astronomisë*⁷ nuk është arsye me u pagua. E vërtetë që këto dije mund të përdoren në artet tjera, p.sh., në shitje, korrigjimin e teksteve, inxhinjeri, muratori, e me radhë, por, kështu do të kalonim në artet utilitare ose të bukura.

Çashtja nuk është me i klasifikua njerëzit sipas një pikpamieje paragjyquese, por, përderisa njeriu ka nevoja **praktike** dhe **psikologjike**, këto nevoja mund të përmirsohen ose **rafinohen**.

Një mënyrë me kuptua dallimin në mes të trí llojeve të arteve është me krahasua: 1) instrumentistin që luan një pjesë në një koncert, 2) prodhuesin e instrumenteve muzikore, 3) njohësin e parimeve të muzikës.

- Instrumentisti quhet **artist**. Loja e tij ofron kënaqsi psikologjike, të cilën disa mund të mos e konsiderojnë nevojë.
- Prodhuesi i instrumenteve quhet **mjeshhtë**. Prodhimet e tij kanë vlerë praktike përderisa të ketë njerëz që i blejnë ato.
- Njohësi i parimeve të muzikës nuk u ofron klientëve as kënaqsi psikologjike as prodhime as shërbime. Ai mund të quhet **i kulturuom**; por njeriu nuk paguhet për një gjë të tillë. Në fakt, prejse termi ‘i kulturuom’ është një term subjektiv, disa mund të shkojnë aq larg sa edhe

ta mohojnë se ka njerëz më të kulturuar ose të rafinuar se të tjerët; ose t'i njësojnë konceptet 'i kulturuar' ose 'e kulturuar' me paragjykimin.

Renditësi krahasues

Renditësi pasues jep një krahasim pak më të zgjatur:

7 Artet Liberale	7 Artet e Bukura	Artet Udalitare
Vetpërmirues	U shërbejnë të tjerëve	
<i>Shtojnë vlerat personale</i>	<i>Tregohen për kënaqsi psikologjike</i>	<i>Tregohen për dobi praktike</i>
<i>Gramatika</i> është arti i përdorimit korrekt të gjuhës në ligjratë e shkrim. Ajo kërkon korrektesën e shprehjes.	<i>arkitektura</i> : Kombinon funksionin dhe estetikën me ndërtua banesa ose struktura të tjera. <i>letërsia</i> – Npërmjet përsosjes së stilit dhe elementeve të letërsisë, prodhon vepra fiktive e jofiktive.	agronomia avokatnia baritoria botimi i librave doktorinia hidrauliknia karpantjeria korrektimi i teksteve muratoria priftnia prostitucioni tregtia tregtimi i drogave veterinaria, etj.
<i>Logjika</i> është arti i arsyetimit në mënyrë korrekte. Ajo kërkon të vlerat ose kogjenten.	<i>muzika</i> – Npërmjet melodisë, shprehë emocione, rrëfen tregime, dhe kumton idë. <i>piktura</i> – npërmjet përdorimit të ngjyrave, motiveve, dritës, e hijeve shprehë emocione, rrëfen tregime, dhe kumton idë.	
<i>Retorika</i> është arti i bindjes. Ajo kërkon përdorimin efektiv të gjuhës.	<i>poezia</i> : npërmjet gjuhës figurative dhe ritmit, shprehë emocione, rrëfen tregime dhe kumton idë.	
<i>Arithmetika</i> – teoria e numrave <i>Muzika</i> – aplikimi i teorisë së numërave <i>Gjeometria</i> – teoria e hapsinës <i>Astronomia</i> – aplikimi i teorisë së hapsinës	<i>skulptura</i> : npërmjet figurave tridimensionale, shprehë emocione, rrëfen tregime, dhe kumton idë <i>vallzimi</i> : Me anë të ritmit dhe elegancës së lëvizjeve shprehë emocione, rrëfen tregime, dhe kumton idë.	

1. Shërbimi i arteve **të bukura** është dyfish, 1) i japin kënaqsi atij që i prodhon, dhe 2) e ndihmojnë artistin **të paguaj** për jetesën e tij. Në anën tjetër secili prej arteve të bukura mund të degenerojë në art për hir të artit. Për shembull, një violinist e ban violinën të tingllojë si zog, një poemë shfaqë mjeshtrinë ritmike e rimuese, e të tjera. Me shmagë artin për hir të artit, artistit duhet të zgjedhi subjektin e trajtimit dhe të ketë një qëllim specifik. Fatkeqsisht, qëllimi mund të cakojë si për të mira si për të liga

2. Artet **utalitare** i ndihmojnë mjeshtrit **të paguaj** për jetesën.

3. Zotnimi i arteve **liberale** gjindet brenda mendjes së njeriut. Prejse mendja nuk i dihet kujt, pasunia e këtij zotnimi mbetet e pamatëshme. Fatkeqsisht, artet liberale, as nuk trashëgohehn as nuk dhantohet (G, D). Tipikisht, ato mësohen në shkollë. Nxanja e arteve liberale kushton shumë, kërkon përpjekje të mëdha, dhe merr kohë të gjatë. Këtu arte, jo vetëm qe nuk i ndihmojnë personit të përballojë shpenzimet e jetesës, por ato edhe e fusin atë në përllim (Gjeçovi) të madh.

Atëherë, përse nevojitet studimi i arteve liberale? Sepse ato të mësojnë **si me jetua**. Përse nevojitet triviumi? Duke qenë baza e *leximit*, *dëgjimit*, *shkrimit*, dhe *ligjratës*, triviumi formon bazat e edukimit. Æsht e vështirë me mësua një landë tjetër pa zotnua triviumin.